



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
ZËDHËNËSI

Tiranë, më 05.01.2014

Njoftim për Shtyp

KLSH KALLËZON NË PROKURORI
ISH-DREJTUESIT E ALUIZNI SHKODËR

Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të programit të auditimit nr. 576/1, datë 29.6.2013 ka ushtruar auditim në **Agjencinë Rajonale të Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Shkodër**, për veprimtarinë e agjencisë në periudhën Janar 2011- Dhjetor 2012.

Nga ky auditim u konstatuan një sërë shkeljesh, për të cilat KLSH ka dërguar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër për 6 ish përgjegjës sektori të këtij institucioni, G.L., E.SH., P.K., N.J., B.J. dhe F.P., me akuzën e shpërdorimit të detyrës për mangësi, shkelje e të meta që bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, konkretisht për:

- Moszbatimin e procedurave ligjore në mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për mënyrën dhe afatin e kualifikimit të dokumentacionit të dosjes së legalizimit të objektit informal, për përgatitjen dhe dërgimin e dokumentacionit për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga Shteti tek poseduesi i ndërtimit pa leje si dhe **shkaktimin e mungesës së të ardhurave në Buxhetin e Shtetit për fondin e kompensimit monetar për subjektet ish-pronarë, në vlerën 177,832,630 lekë.**

-Lejim të parregullsive në plotësimin e dosjeve, duke legalizuar objekte në kundërshtim me ligjin si:

Për 50 objekte (dosje) janë kryer procedurat e dhenies së lejes së legalizimit dhe kalimit të pronësisë (rregjistrim në ZVRPP), për objekte ndërtimore të ngritura pa leje, në kundërshtim me ligjin nr. 9482, 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integritetin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

- Për **50 raste**, për sipërfaqen **20,038 m²**, janë arkëtuar më pak në vlerën **177,832,630 lekë**, duke shkaktuar dëm në Buxhetin e Shtetit, pra të ardhura të munguara për fondin e kompensimit monetar të ish pronarëve. Kjo diferencë ka ardhur nga moszbatimi i drejtë i mënyrës së llogaritjes së sipërfaqeve të poseduara si parcela ndërtimore të paguara, me sipërfaqen e vërtetuar, të përcaktuar në VKM dhe sipërfaqen që zotëron në fakt poseduesi i ndërtimit informal, duke mos marrë në konsideratë Urdhrin nr. 291 datë 1.9.2008, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI –t “Manualin për hartimin dhe paraqitjen e materialeve grafike”.

- Këto sipërfaqe ndërtimore, të zvogëluara gjatë procedurës së legalizimit, në asnjë rast nuk mund të parcelizoheshin, por i duheshin shitur poseduesve me vlerën e tregut, vlerë kjo e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

- kanë rezultuar diferenca të sipërfaqeve të evidentuara nga auditimi i KLSH, në krahasimin ndërmjet sipërfaqeve të zëna sipas vetëdeklarimeve, ortofotove dhe skicave fushore që administrohen në çdo dosje vetëdeklarimi. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 3,17, 17/1 dhe neni 20 të ligjit nr. 9482, 03.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar,
- nuk është respektuar kufiri dhe raporti ligjor i pagesës, mes sasisë së bonove të privatizimit dhe pagesës me lekë në dorë në dy raste, **duke sjellë një dëm ekonomik në arkën e shtetit në vlerë 716,200 lekë, për sipërfaqe të legalizuara prej 779,84 m2.**

Për rrjedhojë, janë favorizuar deklaruesit e ndërtimit informal. Këto veprime bien në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 10219, datë 4.02.2010 “Për disa shtesa në nenin 20/c të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve Pa Leje”, të ndryshuar dhe me nenin 25 të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006.

Për të gjitha veprimet e mësipërme, KLSH i ka përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër të gjitha provat dhe dokumentet përkatëse, përmes kallëzimeve për shpërdorim detyre për ish-përgjegjës të sektorëve të Legalizimit, Rregjistrimit dhe Hartografisë.

Gjithashtu, KLSH i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t fillimin e procedurave administrative e ligjore për dhënien e masës disiplinore “Ndërprerje të marrëdhënieve të punës” për ish drejtorin dhe gjashtë përgjegjës dhe ish-përgjegjës sektori të ALUIZNI-t Shkodër.